



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:009652

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523181

P.nr.31/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit A.Ç nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Lëndim I lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/IL.nr.37/22 të datës 28.01.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt.22.02.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarit B. T. dhe të pandehurit me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Q. B.me dt.23.02.2024 mori dhe shpalli , ndërsa me dt.22.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.Ç nga fsh...-Kaçanik, i lindur më dt. ..., nga i ati Sh... dhe e ëma S..., e gjinisë M..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse datë 04.01.2021 rreth orës 12:00 në Kaçanik, rruga "Vëllezërit Çaka" me dashje me qëllim të shkaktimit të lëndimeve trupore të dëmtuarit B.T ,si pasojë e një mosmarrëveshje parapake rreth një borxhi, të cilin i pandehuri nuk e kishte paguar një natë më parë kur kishte qenë në lokalin "... " ku punonte i dëmtuari, ashtu që deri sa të njëjtit takohen afër dyqanit "... " dhe fillojnë të flasin për borxhin, aty fillimisht fillon konflikti fizik mes tyre, ashtu që i pandehuri e kap për pjesën e përparme duke e shtyrë, por ndërhyjnë A.T dhe L.I për ti ndarë, dhe pasi që i pandehuri dhe i dëmtuari janë shmangur prapa dyqanit të lartëcekur, të njëjtit prapë kanë patur konflikt fizik, me të cilin rast i pandehuri e godet të dëmtuarin me një mjet të përshtatshëm që mund ti shkaktojë lëndime dhe atë me një bishte të fshesës në kokë si dhe në vetull. Si pasojë e kësaj pëson lëndime trupore dhe atë plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e mbivetullës së djathtë dhe gjakmbledhje nënlëkurore në regjionin e pasëm të kokës, dëmtime këto të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë veprim, i pandehuri A.Ç ka kryer veprën penale, Lëndim të lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së,

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70, 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim konfor nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € .

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë ne afatin prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërise së këtij aktgjykimi dhe atë në dy këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari B.T nga Kaçaniku, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.37/22 të datës 28.01.2022, të pandehurin A.Ç nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Lëndim të lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata caktoi dhe mbajti senacën e shqyrtimit fillestar me dt.07.12.2022, me të cilin rast pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori I shtetit, I pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.22.02.2024, prokurori I shtetit Albert Zejnullahu në fjalën e tij deklaroi se mbetet në tërësi pranë akatkuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate. Në fjalën e tij përfundimtare theksoi se, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar provat personale dhe materiale te cilat janë shoshitur mjaftueshëm e me te cilat bindshëm vërtetohet se i pandehuri A.Ç ka kryer veprën penale ne kohen ,vendin dhe mënyrën e përshkruar ne aktin akuzues .Nuk eshte fare kontestuese se ne mes te pandehurit dhe te dëmtuarit fillimisht është filluar me fjalë, eshte tensionuar situata dhe se kanë patur një përplasje në mes vete, kjo nuk mohohet nga askush. Nuk eshte kontestuese se ka patur edhe dëshmitarë të cilët kanë dëshmuar para gjykatës ,kjo me se miri vërtetohet nga deshmi ja e te dëmtuarit i cili në menyrë kronologjike ka përshkruar të vërtetën se si i ka ndodhur rasti, e që kjo dëshmi e të dëmtuarit ka gjetur mbështetje dhe vërtetohet edhe nga deshmi ja e dëshmitarit A.T dhe dëshmitarit L. I., e te gjitha këto janë te mbështetura edhe nga provat materiale siq janë: raporti mjekësor dhe akt-ekspertimi mjeko ligjor. Sa i përket mbrojtjes se te pandehurit se kete e ka kryer ne vetëmbrojtje nuk qëndron, pasi qe mbrojtja e nevojshme kryhet ne raste specifike e që është e domosdoshme për t'a zmbropsur sulmin e kundërligjshëm real dhe të atëqastshëm ndaj vetes apo personit tjetër, por me kusht që të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut. Keto elemente nuk permbushen për shume arsye. Është cekur edhe nga i dëmtuari, por edhe nga dëshmitari A.T, i cili në deshminë e tij si në polici ashtu edhe para gjykatës ka

deklaruar “ A...ka ardhur me nje bisht fshise nga mbrapa dhe e ka goditur përmas B...ne pjesën e pasme te kokës ...” shtrohet pyetja se : se si është e mundur vetë mbrojtja duke e goditur dikand nga mbrapa. Kjo eshte konstaktu edhe ne eks.mjeko ligjor, po ashtu edhe nga dëshmitari L.I, i cili e tregoj pjesën se ku e ka pare gjakun tek i dëmtuari . Per te ekzistuar vepra penale, Lëndim i lehte trupor duhet te plotësuar disa kushte, e si kusht kryesor eshte shkaktimi i lëndimit të personit tjetër me kushte të parapara, e që ne rastin konkret fare nuk është kontestuese lëndimi, fare nuk është kontestues mjeti me të cilin është kryer si dhe fare nuk eshte kontestuese se kete e ka kryer i pandehuri Andaj, bazuar në të lartëcekurat, kërkon nga gjykata që të pandehurin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë konform ligjit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese, mënyrën e kryerjes se veprës penale qe nënkupton me nje mjet te përshtatshëm per shkaktimit e lëndimit të rëndë trupor , dashjen e tij pasi qe kontinuiteti i fjalimeve dhe i rastit të parë kur janë ndarë me rastin e goditjes me kete mjet, ka kaluar një kohë si dhe pasojën e shkaktuar. Poashtu gjykata të ketë parasysh edhe te kaluarën dhe karakteristikat e tij personale ashtu qe me sanksionin e shqiptuar te arrihet qëllimi i dënimit sikurse te vetë i pandehuri si preventiv speciale e po ashtu te ndikojë edhe tek te tjerët që të përmbahen në kryerjen e veprave penale si preventivë gjenerale .

I dëmtuari e mbështet ne tërësi fjalën perfundimtare te Prokurorit te shtetit .

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza. Në mbrojtjen e tij ka theksuar se ditën kritike ka qenë te lokali i L... (...) ku ka biseduar me A.T lidhur me një borgj për pijet e konsumuara në lokalin “...”në të cilin kanë punuar ky I fundit dhe I dëmtuari, me të cilin rast I pandehuri I kishte thënë A...se atë ditë do t’a kryej pagesën.Në ndërkohë aty kishte ardh edhe I dëmtuari I cili I kishte thënë të pandehurit “jeni msu ju me bo poterë ne at kafiq “ dhe e kishte goditur I pari të pandehurin dhe e kishte kapur për fyti, por që I kishte ndarë A.T , L.O dhe A.T. Pas kësaj B... e ka marrë nje tullë-kubëz betoni dhe me të cilën të pandehurin e ka goditur mbrapa në kokë dhe në shpinë, dhe pastaj B...n e ka kapur-larguar A.T, dhe pasi qe e ka parë babën e B...t dhe pasi që B... i tha A... “lejme se du mu marr vesh me ta” B... e ka kap të pandehurin dhe e ka qit mbrapa lokalit me A... me të cilin rast B... e ka goditur të pandehurin me grusht, dhe kur e kishte vërejtur edhe babën e B...t duke vrapuar në drejtim të tij, I pandehuri thot se kishte kapur një bisht të fshisës për t’u vetmbrojtur, dhe pastaj kishte hyrë në lokalin e lartëcekur. I njejt poashtu ka theksuar se gjatë kohës s aka qenë në local, B... ka tentuar që t’a godasë me dru të pandehurin, mirëpo ky I fundit me ndihmën e A.T është larguar prej lokalit. I pandehuri

poashtu ka theksuar se për lëndimet e marra në këtë rast, ka qenë te mjeku ne Kacanik ,dhe është deklaruar ne Stacionin Policor në Kacanik, dhe ka qëndruar ne mbajtje per 48 orë .

Në pyetjen e prokurorit, I pandehuri ka theksuar se I përmbahet deklaratës së dhënë në polici, lidhur me rastin konkret. Me rastin e ballafaqimit të tij me deklaratën e dhënë në polici, gjegjësisht me fjalët e cekura në rreshtin 2,3 dhe 4 të deklaratës, I pandehuri deklaroi se e vërteta është ajo që e ka thënë në polici se e ka goditur B...n në vetëmbrojtje, gjersa B... ka qenë përballë tij.

Mbrojtësi i te pandehurit ne fjalën e tij perfundimtare deklaroi se, duke u bazuar ne rrjedhën e zhvillimit të procedurës si dhe duke e patur për bazë aktakuzën e prokurorit te shtetit, ku është bërë edhe administrimi i provave, ku nga kjo i mbrojturi I tij, si ne deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 04.01.2022, e ka pranuar qe e ka goditur te dëmtuarin- B.T, si dhe gjate këtij shqyrtimi gjyqësor I mbrojturi I tij deklaroi se e ka goditur te dëmtuarin me bisht të fshisës , por këtë e ka bërë për tu mbrojtur, për shkak se i dëmtuari e kishte goditur i pari, dhe kjo vërtetohet edhe nga deklarata e te dëmtuarit B.T, I cili e pranon se e ka goditur me një ose dy shuplaka . Por nga lëndime qe ka marr i pandehuri A. Q., bazuar në raportin mjekësor të dt. 04.01.2022 nga QKMF – Kaçanik, mjeku konstaton se A... ka hematomë në kokë, konkretisht ne anën e majte te kokës si dhe ka gervishje në shpinë, me qka le të kuptohet se është përdorur mjete ose tulla per goditjen e të pandehurit. Sa i përket dëshmitarit L.I gjate seancës se shqyrtimit gjyqësor është me rëndësi te ceket se I njejt i ka theksuar se gjate bisedës, A... nuk e ka goditur B...n, (e kishte fjalën për konfliktin e parë para lokalit) para por vetëm I ka ulur dorën të njejt, dhe pas gjithë këtij konflikti A... është futur duke ikur në një local, dhe B... prapë ka tentu me hy mbrenda. Prandaj edhe kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit te ndonjë sanksioni penal, t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe njeherit dënimi i shqiptuar të jete i justifikushem dhe të shërbej si parandalim për kryerjen e veprave penale në të ardhmen . Fjala e mbrojtësit mbështetet në tërësi edhe nga I pandehuri.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor prezantoi provat e propozuara me dëgjimin e të dëmtuarit B.T, në cilësi të dëshmitarit dhe dëgjimin e dëshmitarëve: A.T dhe L.I dhe me administrimin e provave material si: leximin e raportit i oficerit me nr. te rastit 2022-CE-04 e dt. 04.01.2022 , deklarata e te dëmtuarit B.T e dt. 04.02.2022, raporti mjekësor nga QKMF-së Kacanik me nr. prot.641 të dt. 04.01.2022, fotodokumentacioni ,deklarata e te pandehurit A.Ç e dt. 04.01.2022, raporti mjekësor i të pandehurit i dt. 04.01.2022, deklarata e dëshmitarit A.T i dt. 04.01.2022,

deklarata e dëshmitarit L.I i dt. 04.01.2022 dhe ekspertiza mjeko ligjore e dt. N. U. e dt. 23.01.2022.

I dëmtuari B.T, në dëshminë e saj para gjykatës deklaroi se, ditën kritike ka ndodhur një përleshje, pasi që ishte kthyer prej pune, dhe ate pasi që kishte arritur te lagjia e tij, gjegjësisht afër dyqanit të pemtarisë “Aga “ në rrugën “Vëllezrit Çaka”, ku e kishte takuar të pandehurin, i cili kishte qene duke debatuar me djalin e axhës së të dëmtuarit, A.T lidhur me një borgj të një nate më herët, për shkak të mospagesës së pijeve në kafiterinë “...”. Dëshmitari thekson se, pasi që ishte afruar afër tyre, që të merren vesh dhe të sqarohen me të pandehurin për çështjen e mospagesës së pijeve, i pandehuri fillon t’a kercnojë dhe e godet me grusht në gjoks dhe pasi që e shtyen, dëshmitari rrëzohet në tokë, por që është ngritur dhe kur I pandehuri ka tentuar t’a godasë prapë, aty filloi përleshja mes tij dhe të pandehurit, por që kishte ndërhy A.T dhe I kishte nda. Dëshmitari më tutje thekson se pas kësaj, e kishte marrë të pandehurin dhe kishin shku mbrapa lokalit të lartëcekur, për mos mi pa të tjerët, , me pëlqimin edhe të pandehurit, dhe aty I kishte thënë të pandehurit se nuk mundet që tá godasë se ka ngrënë bukë në shtëpinë e tij, meqë I dëmtuari thot se njihej dhe shoqërohej me vëllezërit e të pandehurit, dhe me kaq kishte përfunduar.Por pas 1-2 minutave gjersa i dëmtuari ka qenë duke biseduar me djalin e axhës, A.T, kishte ardh A... me një dru dhe e ka goditur prapa veshit të djathtë dhe ne pjesët e tjera te kokës dhe mbi pjesën e syrit të djathtë dhe pas kësaj A... ka hyrë te dyqani i lartëcekur, dhe pranon se pas kësaj goditje nga I pandehuri ka dashur që të hyjë në këtë local ku ishte I pandehuri, mirëpo nuk është lejuar nga prindi I tij dhe A.T dhe persona tjerë që kanë qenë aty.Dhe pas kësaj, me ndihmën e shpejtë ka ardh në emergjencë në Kacanik dhe pastaj ka dhënë deklarat ne stacionin policor ne Kacanik. I dëmtuari poashtu ka theksuar se me te pandehurin ka patur edhe raste te tjera, te cilat sipas tij, sigurisht janë të evidentuara ne gjykatë , derisa lidhur me lëndimet raportin mjekësor të të pandehurit, thot se këto lëndime I pandehuri I ka patur më herët për shkak të problemeve tjera, ndërsa ai nuk I’a ka shkaktuar këto lëndime.

Dëshmitari A.T në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se, ditën kritike derisa ka qenë afër dyqanit të pemtarisë “...” , I dëmtuari dhe I pandehuri, fillimisht janë fjalosur lidhur me një pagesë të pijeve në kafiterinë “...” dhe pastaj për shkak të konfliktit fizik, dëshmitari bashkë me L.In kanë ndërhyrë për t’I ndarë, mirëpo I pandehuri dhe I dëmtuari kane dal në një pjesë mbrapa lokalit të lartëcekur, dhe pasi dëshmitarit I është krijuar përshtypja që këta të fundit janë sqaruar, në momentin kur I dëmtuari- B..., ka qenë duke ecur i pari, dëshmitari I dyti, I pandehuri kishte ardh me një bisht fshise në dorë, dhe nga

mbrapa e ka goditur B...n, ne pjesën e pasme te kokës. Pas kësaj dëshmitari e ka larguar A..., I cili ka hyrë në lokallin e lartëcekur, derisa A.T dhe L.I e kanë penguar të dëmtuarin që të hyjë në lokal ku ka qenë I pandehuri.

Dëshmitari L.I, në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se, ditën kritike kishte qenë te lokali “...” ku edhe punon, ku kishte ardh edhe I pandehuri-A..., dhe bashkë edhe me A.T, i cili ka ardhur rastësisht, kanë biseduar me te për çështjen e mospagesës së pijeve në kafene , një natë më parë. Gjatë kësaj bisede, rastësisht ka ardhur edhe B.T, me të cilin rast ky I fundit është përfshirë në bisedë duke fol edhe me duar dhe gjeste, dhe pasi që A... i ka thënë se pse po fol edhe me duar dhe e ka ngrit dorën per me ja ul dorën B...t, ne ato momente B... e ka kapur A...n dhe kane fillu me godit njeri tjetrin, por që ka ndërhyrë dëshmitari bashkë me A.Tn dhe I kan ndarë. Pas kësaj dëshmitari thot se ka vazhdu që të merret me myshteri të lokalit ku punon, ndërkohë I ka pa bashkë, A...n ,B...n dhe A..., nuk i kujtohet nëse ka qene edhe A.T , dhe kame menduar se nuk do të vazhdojnë problemin prapë. Mirëpo në ndërkohë, A... kishte ardhur me vrap dhe ka hyrë në lokalin e dëshmitarit (pemtaria ...) dhe pas tij ka ardh edhe A..., derisa B... me prindin e tij kanë tentu me hy brenda në local, por nuk janë lejuar nga A.T dhe myshteria që ka qenë në local.Me ndihmën e A.Tt, A... është larguar prej lokalit. Dëshmitari deklaroi se nuk ka vërejtur nëse B... ka marrë ndonjë guri apo kubëz betoni, por që të tillë ka patur në tokë, derisa thekson se, pasi që A... ka hyrë në lokalin e tij, ka vërejtur që B... ka pasur gjak ne pjesën e pasme të veshit ,

Nga këto dëshmi, gjykata vërtetoi se ditën kritike, pasi që I pandehuri ishte takuar rastësisht me të dëmtuarin para dyqanit të pemptarisë “...” , si pasojë e mosmarrëveshjes rreth një pagese për pije në kafiterinë “...”ku I dëmtuari ka punuar, kanë patur një konflikt fizik, në të cilin kanë ndërhyrë për t’I ndarë A.T dhe L.I. Pas këtij konflikti, I dëmtuari me të pandehurin shkojnë prapa dyqanit të pemptarisë “...”për të vazhduar kinse me bisedën për tu sqaruar për pagesën e pijeve, dhe aty ndodh prapë konflikt fizik, me të cilin rast, I pandehuri , e godet të dëmtuarin me një mjet të përshtatshëm që mund ti shkaktojë lëndime dhe atë me një bishte të fshesës në kokë si dhe në vetull. Si pasojë e kësaj goditje, i dëmtuari pëson lëndime trupore dhe atë plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e mbivetullës së djathtë dhe gjakmbledhje nënlëkurore në regjionin e pasëm të kokës, dëmtime këto të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata u fali besimin, deklaratës së të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit dhe deklaratave të dëshmitarëve, A.T dhe L.I, meqë të njejtat gjejnë mbështetje në njëra tjetrën, në provat materiale por edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurit.

Fakte të njejtat sikurse me deklarata e dëshmitarëve, u vërtetuan edhe nga leximi i raportit i oficerit me nr. te rastit 2022-CE-04 e dt. 04.01.2022 , deklarata e të dëmtuarit B.T e dt. 04.02.2022, raporti mjekësor nga QKMF-së Kacanik me nr.prot. 641 të dt. 04.01.2022, fotodokumentacioni, deklarata e të pandehurit A.Ç e dt. 04.01.2022, raporti mjekësor i të pandehurit i dt. 04.01.2022, deklarata e dëshmitarit A.T i dt. 04.01.2022, deklarata e dëshmitarit L.I i dt. 04.01.2022 dhe ekspertiza mjeko ligjore e dt. N. U. e dt. 23.01.2022.

Pas prezantimit të provave dhe vlerësimit të tyre te plotë, secilën veç e veç dhe të gjitha në tërësi, mbrojtjes se të pandehurit si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si ne dispozitiv.

Gjykata u dha besimin edhe provave materiale, sepse me të njëjtat ne mënyrë të qartë dhe bindëse është përshkruar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, dhe se këto prova gjenë mbështetje edhe në dekalrimet e dëshmitarëve dhe edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurit.

Gjykata vlerësoi posaçërisht edhe mbrojtjen e të pandehurit, ku i njëjti thot se ditën kritike si pasojë e mosmarrëveshjes me të dëmtuarin, këtë të fundit e kishte goditur me një bisht fshise për t'u vetëmbrojtur, duke e patur përballë të dëmtuarin, dhe pasi që I dëmtuari e kishte goditur më parë me grusht, për çka edhe ka patur kontrollë mjekësore në QKMF Kaçanik. Gjykata poashtu vlerësoi edhe mbrojtjen e të pandehurit të dhënë përmes mbrojtësit të tij, av.Q. B., se I mbrojturi I tij e kishte goditur të dëmtuarin, pasi që fillimisht I mbrojturi I tij ishte goditur nga I dëmtuari, për çka ekziston edhe raporti mjekësor, dhe faktin se I dëmtuari edhe pas përfundimit të konfliktit ka tentuar që t'a sulmojë të pandehurin, duke tentuar që të hyjë në lokalin ku I pandehuri kishte hyrë, pasi që e kishte goditur të dëmtuarin.

Mbrojtjes së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, se I pandehuri ka patur kontrollë mjekësore në QKMF Kaçanik, gjykata I fali besimin meqë ky fakt vërtetohet edhe nga raporti mjekësor me nr. regj. 672 I dt.04.01.2022, në të cilin konstatohet hematomë në anën e majtë të kokës dhe gërvishje në shpinë, por edhe nga vetë deklarata e dëshmitarëve, të cilët vërtetojnë se I

pandehuri dhe I dëmtuari kanë patur fillimisht një konflikt fizik para dyqanit të pemptarisë “...” e pastaj, konflikti ka vazhduar edhe mbrapa lokalit të lartëcekur. Prandaj është e logjikshme që në rastin konkret edhe I pandehuri mund të ketë pësuar ndonjë lëndim eventual trupor, por mbrojtjes së të pandehurit, se të dëmtuarin e ka goditur në vetëmbrojtje, gjykata nuk I fali besimin meqë nga provat e adminstruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e sidomos nga raporti mjekësor në emër të të dëmtuarit, ekspertiza mjekoligjore si dhe fotografitë e të pandehurit, vërehet qartë se të dëmtuarit, përveq pjesës së mbivetullës së djathtë, I është shkaktuar lëndim trupor edhe në pjesën e pasme të kokës, konkretisht në pjesën pas veshit të djathtë.

Kjo pasi që situata në rastin konkret është e qartë, se sulmi I të pandehurit nuk ka ndodhur gjatë sulmit të të dëmtuarit, ose pritjes së fillimit të sulmit nga I dëmtuari, por sulmi I të pandehurit ka ndodhur, pasi që I dëmtuari ka pushuar së vepruari, prandaj çdo veprim i mëtejshëm i I të dëmtuarit në këtë rast, nuk mund të konsiderohet mbrojtje e nevojshme, por si veprim I ndërmarrë për shkak të hakmarrjes apo edhe frikës.

Ndërsa fakti se, I dëmtuari pasi që është goditur nga I pandehuri, ka tentuar që të hyjë në local ku ka qenë I pandehuri, kjo është e saktë, meqë ky fakt tani më është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor me ndëgjimin e dëshmitarëve A.T dhe L.I, por edhe nga dëshmia e të dëmtuarit, dhe që për gjykatën kjo tregon edhe gatishmërinë e të dëmtuarit që të hakmerret për goditjen që I ishte bërë nga I pandehuri. Gjithsesi, në rastin konkret, për shkak të ndërhyrjes së A.T, A.T dhe L.I, I pandehuri ka arritur të largohet nga lokali pa patur ndonjë konflikt tjetër me të dëmtuarin.

Gjykata pas analizimit të mbrojtjes së të pandehurit në rastin konkret, vlerëson se ky I fundit arsyetimin se kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme, e ka bërë duke tentuar që t’I shmanget përgjegjësisë penale për rastin konkret.

Nisur nga të gjitha këto fakte të vërtetuara në procedurë, gjykata vërtetoi se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që në rastin gjykata pati parasysh si rrethanë lehtësuese situatën në të cilën ka vepruar I pandehuri, duke qenë se ata, si pasojë e

mosmarrëveshjes përmes bisedës, kanë patur konflikt fizik me të cilin rast të dytë e kanë goditur njeri tjetrin, e për pasojë edhe vetë I pandehuri ka patur kontrollë mjekësore për lëndimet eventuale të pësuar, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh faktin se, I pandehuri, bazuar në evidencën penale të kësaj gjykate, raporti I së cilës I është bashkangjitur shkresave të lëndës, ka patur edhe rast penal të natyrës së ngjashme për të cilin është gjykuar me dënim me burgim.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurin A.Ç, i akuzuar për veprën penale, Lëndim I lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhezimin e të dëmtuarit në contest civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 31/22 datë 22.03.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.